



BASHKIMI I SINDIKATAVE TË PAVARURA TË KOSOVËS
THE UNION OF INDEPENDENT TRADE UNIONS OF KOSOVA

Adresa:Rr."Nëna Terezë" 35, 10 000 PRISHTINË,
Tel/fax:++381(0)38 229 838, e-mail:bspk@etuc.org

Reagim

Ndaj ngritjes së çmimit të bukës dhe të artikujve të tjerë ushqimorë

Prishtinë, 20 dhjetor -Këto ditë jemi dëshmitarë të rritjes së çmimeve të bukës dhe të shumë artikujve ushqimorë. BSPK-ja shpreh shqetësimin e vet dhe reagon ashpër për këtë dukuri e cila direkt atakon popullatën e Kosovës e sidomos shtresën e cila jeton në varfëri të skajshme. Rritja e këtyre çmimeve e rrezikon standardin e më shumë se 70% të popullatës.

BSPK-ja kërkon nga Qeveria e Kosovës që të intervenojë me mjete të nevojshme në mënyrë që çmimi i bukës të mos ngritet dhe të bëhet i papërballueshëm për shumicën e punëtorëve dhe qytetarëve të Kosovës.

Përderisa konsiderohet, se shtrenjtimi i bukës është i papërballueshëm, furrтарët këtë veprim e arsyetojnë me rritjen e çmimit të grurit dhe miellit në tregun botëror.

BSPK-ja gjithashtu kërkon nga Qeveria e Republikës së Kosovës që përmes lehtësimeve të ndryshme t'u ndihmojë furrтарëve dhe atyre që e bëjnë furnizimin me miell në mënyrë që të mbahet nën kontrollë ngritja e çmimit të këtij artikulli. Ndryshe grevat do të jenë të pashmangshme!

Zyra për Informim, BSPK
Fatma Rastelica

Kryetari i BSPK-së
Haxhi Arifi